



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 19 tetor 2011
Nr. ref.: RK 143 /11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMERI

në

Rastin nr. KI 67/11

Parashtruesi

Z. Selim Berisha

Vlerësimi i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës
A.nr.85/2011, të 31 marsit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKES SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Cukalovic, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Selim Berisha nga Prishtina, me banim në Prishtinë në rrugën 'Shkodra', nr. 21.

Vendimi i kontestuar

2. Vendim i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 85/2011, i datës 31. 03. 2011, me anë të të cilit është refuzuar kërkesa për vlerësimin e ligjshmërisë së Aktvendimit me nr. të dosjes 5097046, të Këshillit të Ankesave të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejme: MPMS) lidhur me të drejtën për pension për personat me aftësi të kufizuar.

Objekti i çështjes

3. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, më 24 maj 2011, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 85/2011, të datës 31. 03. 2011, të cilin parashtruesi i kërkesës, sipas pohimit personal, e ka pranuar më 08. 04. 2011.

Baza ligjore

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 16 dhjetor 2009, i hyrë në fuqi më 15 janar 2010 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe neni 29 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 24 maj 2011, z. Selim Berisha parashtrroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës me të cilën kërkonte vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 85/2011, të datës 31. 03. 2011.
6. Më 24 qershor 2011, Gjykata Kushtetuese e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e lëndës duke kërkuar edhe përgjigje me shkrim nga palët.
7. Më 21 korrik 2011, parashtruesi i kërkesës i dërgoi Gjykatës Kushtetuese përgjigje me shkrim, duke ia bashkangjitur edhe vendimet e MPMS-së lidhur me refuzimin e kërkesës së tij.
8. Më 17 gusht 2011, Kryetari e caktoi gjyqtarin Robert Carolan për Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova, (kryesuese), Mr. Sc. Kadri Kryeziu dhe Dr. Gjyljeta Mushkolaj, anëtarë të Kolegjit.
9. Më 5 tetor 2011, pas raportimit të Gjyqtarit raportues Robert Carolan, Kolegji shqyrtues në përbërje nga gjyqtarja Snezhana Botusharova (kryesuese), Mr. Sc. Kadri Kryeziu dhe Dr. Gjyljeta Mushkolaj, anëtarë të Kolegjit, njëzëri i propozoi përbërjes së plotë të Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 2 qershor 2010, z. Selim Berisha i kishte parashtruar kërkesë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamentit të Administratës Pensionale të Kosovës me të cilën nga ky institucion ka kërkuar njohjen e të drejtës për pension të personave me aftësi të kufizuara.
11. Më 6 shtator 2010, Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës kishte nxjerrë vendimin me të cilin kishte refuzuar kërkesën e z. Berisha me arsyetimin se

komisioni mjekësor ka konstatuar se tek ai **nuk ekziston “aftësia e kufizuar e plotë dhe e përhershme”**. Këtë vendim z. Selim Berisha e kishte pranuar më 6 tetor 2010.

12. Më 7 tetor 2010, z. Berisha ka ushtruar ankesë kundër këtij vendimi në Këshillin e Ankesave për pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara, që vepron në kuadër të MPMS-së për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes shëndetësore të paraqitësit të kërkesës për pension me aftësi të kufizuara.
13. Më 25 nëntor 2010, Këshilli i ankesave për pensionet e personave me aftësi të kufizuara me Aktvendimin me nr. të dosjes 5097046 ka refuzuar si të pabazuar ankesën e z. Selim Berisha, duke konstatuar se vendimi i shkallës së parë ka qenë i bazuar në ligj dhe i drejtë. Këtë aktvendim, z. Berisha e kishte pranuar më 10 janar 2011.
14. Më 26 janar 2011, z. Selim Berisha ka parashtruar padi në Gjykatën Supreme të Kosovës duke kërkuar vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të Këshillit të ankesave të MPMS-së, duke e cilësuar at aktvendim si jo të bazuar, sepse sipas tij, ai ka paraqitura dokumentacion mjekësor të mjaftueshëm i cili vërteton paaftësinë e tij të përhershme.
15. Më 31 prill 2011, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktgjykimin A. nr. 85/2011 me të cilin **refuzoi padinë** dhe vlerësoi se komisionet e MPMS-së janë të autorizuar me ligj për vlerësimin e paaftësisë së kufizuar dhe të përhershme për personat që pretendojnë për të drejtën e pensionit të tillë, dhe se në rastin konkret këto komisione kanë vërtetuar se tek z. Berisha një paaftësi e tillë nuk ekziston, prandaj Gjykata Supreme konstaton se organet administrative kanë aplikuar drejt dispozitat ligjore kur kanë vendosur lidhur me këtë rast, dhe se ekzistojnë të gjitha kushtet që padia të refuzohet. Këtë Aktgjykim z. Berisha e kishte pranuar më 08.04.2011.
16. Më 24 maj 2011, përfundimisht i pakënaqur me të gjitha vendimet e organeve administrative e gjyqësore, z. Selim Berisha ka parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i ankesës ka pohuar se komisionet mjekësore të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejme: MPMS) ia kanë refuzuar në mënyrë jologjore të “drejtën për pension me aftësi të kufizuara”, edhe pse ai i ka plotësuar kushtet për një pension të tillë, ndërsa Gjykata Supreme e Kosovës duke refuzuar padinë e tij lidhur me këtë çështje, gjithashtu ka bërë të njëjtën shkelje, sepse, sipas parashtruesit të ankesës, ai ka paaftësi të përhershme për punë dhe atë e ka provuar edhe me dokumentacion mjekësor.
18. Parashtruesi i kërkesës nuk ka përcaktuar saktësisht se cila e drejtë e garantuar me Kushtetutë i është cenuar, por ka theksuar se atij i është mohuar **“e drejta në pension me aftësi të kufizuara”**.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

19. Për të qenë në gjendje për të gjykuar mbi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të cilat përcaktohen me Kushtetutë.
20. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës që përcakton se:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

21. Gjykata, gjithashtu merr parasysh:

Rregullin 36 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese ku përcaktohet:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
c) Kërkesa është qartas e bazuar.

22. Në fakt, duke iu referuar shkeljes së supozuar të së drejtës për pension, Gjykata konstaton se Kushtetuta e Kosovës të drejtës së pensionit i referohet vetëm në nenin 105 dhe 109 të saj, edhe atë duke iu referuar procesit të mandatit dhe riemërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, për të cilët përdorët formulimi kushtetues **”deri në pensionim sipas ligjit”**.

23. Në nenin 51 të Kushtetutës [**Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale**], paragrafi 2, është qartazi e paraparë: ”Sigurimi social themelor që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj”.

24. Nga përkufizimi juridik i nenit 51 të Kushtetutës shihet qartë se sigurimi social për “aftësi të kufizuara, papunësi dhe moshë të shtyrë”, rregullohet me LIGJ. Në rastin Konkret, çështja e pensionit me aftësi të kufizuara është e rregulluar me Ligjin NR. 2003/23 PËR PENSIONET E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË KOSOVË, të aprovuar në Kuvendin e Kosovës më 6 nëntor 2003.

25. Procedurat e aplikimit dhe plotësimit të kushteve për gëzimin e kësaj të drejte janë të parapara me këtë Ligj, sikur edhe e drejta e apelimit të vendimeve kur palët nuk janë të kënaqura me vendimet lidhur me kërkesën e tyre.

26. Komisionet administrative të MPMS-së kishin vepruar pikërisht në përputhje me dispozitat e këtij Ligji dhe Gjykata Supreme e kishte konstatuar se këto vendime ishin ligjore .

27. Gjykata Kushtetuese nuk është Gjykatë e vërtetimit të fakteve, prandaj Gjykata Kushtetuese dëshiron të theksojë se konstatimi i gjendjes faktike, të drejtë dhe të plotë, është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe në këtë rast edhe i organeve administrative, dhe se roli i sajë është vetëm që ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, prandaj nuk mund të veprojnë si "gjykate e shkalës së katërt" (shih, *mutatis mutandis*, i.a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).

28. Nga faktet e paraqitura së bashku me kërkesën, shihet se parashtruesi i sajë nuk e ka përmbushur obligimin ligjor të saktësisimit të kërkesës, sepse ai nuk ka specifikuar qartë se cila e drejtë e garantuar me Kushtetutë i është cenuar nga aktet e autoriteteve publike. Për me tepër, Gjykata konsideron se nuk ka asgjë në kërkesë që tregon se Gjykatës, dhe në këtë rast edhe komisioneve të MPMS-së, gjatë ekzaminimit të rastit iu mungonte paanshmëria ose që procedura ishte e padrejtë. Fakti i thjeshtë se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t’u shërbejë atyre si arsye të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (shih *mutatis mutandis* aktgjykim ECHR Appl. No. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).

29. Në këto rrethana, parashtruesi i ankesës nuk ka “argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij, prandaj,

PËR KËTO ARSYE


Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36, paragrafi 2, pikat (b) dhe (c) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese në seancën e 5 tetorit 2011, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Robert Carolan



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. Dr. Enver Hasani